



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.71

2005

27 shtator

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.596, datë 22.9.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.560, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kuotave të pranimeve në universitetet dhe shkollat e larta, për vitin akademik 2005-2006, në sistemin me kohë të plotë, si dhe për përcaktimin e tarifave të shkollimit për këtë vit akademik”.....	2451
Vendim i KM nr.597, datë 22.9.2005	Për shfuqizimin e vendimit nr.547, datë 3.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e shkollës universitare publike “Universiteti i Beratit””.....	2460
Vendim i KM nr.598, datë 22.9.2005	Për shfuqizimin e vendimit nr.546, datë 3.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e shkollës universitare publike “Universiteti i Fierit””.....	2460
Vendim i KM nr.599, datë 22.9.2005	Për shfuqizimin e vendimit nr.548, datë 3.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e shkollës universitare publike “Universiteti i Durrësit””.....	2461
Vendim i GJK nr.22, datë 26.9.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.207, datë 27.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.18, datë 6.2.2002 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.366, datë 7.6.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	2461

VENDIM
Nr.596, datë 22.9.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.560, DATË 12.8.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMEVE NË UNIVERSITETET
DHE SHKOLLAT E LARTA, PËR VITIN AKADEMIK 2005-2006, NË SISTEMIN ME KOHË
TË PLOTË, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR KËTË VIT
AKADEMIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.560, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në universitetet dhe shkollat e larta publike, për vitin akademik 2005-2006, në sistemin me kohë të plotë, të jetë 18 054 studentë dhe të ndahet:

- | | |
|---|---------|
| a) Kuota e pranimeve të reja | 17 414; |
| b) Kuota për degë të dytë | 300; |
| c) Kuota për vite të ndërmjetme | 300; |
| ç) Kuota për shtetasit e huaj, me kombësi joshqiptare | 40.”. |

2. Pika 2 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Kuota e pranimeve të reja përbëhet nga:

- | | |
|--|---------|
| a) Kuota kryesore | 15 610; |
| b) Kuota dytësore | 1 503; |
| c) Kuota për shqiptarët jashtë trojeve të Republikës së Shqipërisë | 301.”. |

3. Në pikën 3, tabelat nr.1 “Kuotat e pranimeve të reja, për vitin akademik 2005-2006”, nr.2 “Kuotat kryesore të pranimeve të reja, për vitin akademik 2005-2006”, nr.3 “Kuotat dytësore të pranimeve të reja, për vitin akademik 2005-2006” dhe nr.4 “Kuotat për kandidatët nga trojet, për vitin akademik 2005-2006”, që i bashkëlidhen vendimit, zëvendësohen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Pika 8 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. Tarifa vjetore e shkollimit për çdo student, që do të regjistrohet në vitin akademik 2005-2006, në kuotat kryesore, përfshirë edhe studentët e kurseve të tjera më të larta, të regjistruar në kuotat kryesore, të jetë në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në vit.”.

5. Pika 10 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“10. Studentët përsëritës, të regjistruar në kuotat kryesore, paguajnë tarifën e shkollimit të përcaktuar në këtë vendim, ndërsa ata të regjistruar në kuotat dytësore, paguajnë tarifë shkollimi të njëjtë me tarifën e shkollimit për kuotat kryesore, të përcaktuar në këtë vendim.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KUOTA E PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

Tabela Nr. 1

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	Σ
1	Histori	120										120
2	Gjeografi	120										120
3	Histori-Gjeografi				90	170		180				440
4	Gjuhë Letërsi	120			140	170	130	160	250			970
5	Fidukim Ojetar				90							90
6	Anglisht	200			90	110	90	90	160			740
7	Frëngjisht	120			60							240
8	Italisht	130			90	90		60	130			500
9	Gjuhë Slave Ballkanike	60										60
10	Gjermanisht	120			40			60				220
11	Gjuhë Letërsi Greke	80				60						140
12	Gjuhë Turke	53										53
13	Cikli i Ujt				180	140	140	160	220			840
14	Cikli i Ujt Parashkollor				110	90	90	90	150			530
15	Fizikulturë	140					80	60			127	280
16	Matematikë	140										200
17	Fiziks	140										280
18	Matematikë-Fiziks				120	80			80			280
19	Biologji-Kimi	120			130	140		160				550
20	Kimi	70										70
21	Kimi Teknologjike dhe udsjmore	70										70
22	Kimi Industriale	70				130						130
23	Matematikë-Informatikë							80				150
24	Informatikë	70							90			90
25	Teknologji Informatiomi	90			80							170
26	Gazetari				110			120				360
27	Punë Sociale	130					90					310
28	Filozofi-Sociologji	130							25			25
29	Pedagogji e Specializuar				120			140				390
30	Psikologji	130										130
31	Shtetësi Politike	130						180	220			760
32	Drejtësi	360										10
33	Regji Film dhe TV									10		10
34	Art Skenik									70		70
35	Art Figurative									77		77
36	Muzikë									107		107
37	Mjekësi	230										230
38	Stomatologji	75										75
39	Farmaci	75										75
40	Infermieri	420			150	100	140	140	230			1180
41	Administrim Publik											150
42	Administrim-Biznes	470			130	150	100	120	220			1040
43	Ekonomiks	95			90							185
44	Financë	470			130	240	160	120				1120
45	Info-Ekonomike	70										70
46	Turizëm					170	90	120	170			550
47	Marketing						90					90

KUOTA E PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AFFS
48	Insh. Dëtare								80		80
49	Navigation								80		80
50	Mekanikë		120								120
51	Insh. Materiale		60								60
52	Tekstil		60								60
53	Elektrik		100								100
54	Elektronik		140								140
55	Ndërtim		230								230
56	Arkiteturë		110								110
57	Insh. Matematike		35								35
58	Insh. Fizike		35								35
59	Insh. Gjosdet		50								50
60	Insh. Ambienti		60								60
61	Insh. Në shkencat e tokës		80								80
62	Gjeoinformatike		60								60
63	Insh. i Gjeoburimeve		100								100
64	Drejtim Fernalsh dhe AGB			200			90				290
65	Ekonomi dhe P. Agrare			200							200
66	Insh. Agr. ne Hortikulture dhe MB			140			90				230
67	Insh. Agr. në P. Bimor			120							120
68	Insh. Agrar ne Zootek. dhe B. Blesk			120							120
69	Akuakulturë dhe M. Peshkimi			130							130
70	Insh. Agronjedis			150							150
71	Tek. Agroushqimore			100							100
72	Agr. Agroushqimor						60				60
73	Vrështari dhe Enologji			60							60
74	Insh. Pjesh			100							100
75	Insh. P. Druri			70							70
76	Veterinari			130							130
	GJITHSEJTI	4678	1240	1520	2040	1840	1440	2160	2105	264	17414

KUOTAT KRYESORE TE PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	Σ
1	Histori	105										105
2	Gjeografi	106										106
3	Histori-Gjeografi				78	156		157				391
4	Gjuhë Letërsi	104			124	153	117	139	2+2			879
5	Educim Qytetar				77							77
6	Anglisht	181			79	99	81	77	1+4			661
7	Frëngjisht	120			60			54				234
8	Italisht	118			79	81		50	117			445
9	Gjuhë Shlaze Ballkanike	60										60
10	Gjermanisht	120			40			50				210
11	Gjuhë Letërsi Greke	80				55						135
12	Gjuhë Turke	50										50
13	Ciklet i Ujt				165	126	125	139	200			755
14	Ciklet i Ujt Parashkollor				100	81	89	66	137			473
15	Fizikulturë										113	113
16	Matematikë	121					79	51				251
17	Fizikë	120						52				172
18	Matematikë-Fizikë				120	75			80			275
19	Biologji-Kimi	104			114	126		141				485
20	Kimi	61										61
21	Kimi Teknologjike dhe ushqimore	61										61
22	Kimi Industriale	61										61
23	Matematikë-Informatikë					118						118
24	Informatikë	60						69				129
25	Teknologji Informatiori								81			81
26	Gazetari	80			70							150
27	Punt Sociale	114			96			108				318
28	Fiziozof-Sociologji	115			81		80					276
29	Pedagogji e Specializuar								25			25
30	Psikologji	113			108			123				344
31	Shkencat Politike	113										113
32	Disiplinë	320						160	200			680
33	Regji Film dhe TV									10		10
34	Art Skenik									68		68
35	Art Figurative									76		76
36	Muzikë									103		103
37	Mjekësi	203										203
38	Stomatologji	64										64
39	Farmacj	64										64
40	Infemieri	374			130	90	124	122	207			1047
41	Administrim Publik					134						134

[illegible]

KUOTAT DYTESORE TE PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

Tabela Nr. 3

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	Σ
1	Histori	12										12
2	Gjeografi	12										12
3	Histori-Gjeografi				9	14		18				41
4	Gjuhë Lëdësi	12			14	17	13	16	8			80
5	Edukim Qytetar				9							9
6	Anglisht	14			9	11	9	9	16			68
7	Frëngjisht							6				6
8	Italisht	12			9	9		6	13			49
9	Gjuhë Slave Ballkanike											0
10	Germanisht							6				6
11	Gjuhë Lëdësi Greke					5						5
12	Cikli i UBT				10	14	14	16	20			74
13	Cikli i UBT Parashtetësor				5	9		15	13			42
14	Fizikulturë										12	12
15	Matematikë	14						5				19
16	Fizikë	12						5				17
17	Matematikë-Fizikë					5						5
18	Biologji-Kimi	12			13	14		16				55
19	Kimi	7										7
20	Kimi Teknologjike dhe ushqimore	7										7
21	Kimi Industriale	7										7
22	Matematikë-Informatikë					12						12
23	Informatikë	6						8				14
24	Teknologji Informatike								9			9
25	Gazetari	8			8							16
26	Punë Sociale	12			11			12				35
27	Filozofi-Sociologji	11			9		9					29
28	Psikologji	13			12			14				39
29	Shkencat Politike	13										13
30	Drejtësi	36						18	20			74
31	Mjekësi	23										23
32	Stomatologji	7										7
33	Farmaci	7										7
34	Infiermieri	37			14	10	14	14	23			112
35	Administrim Publik					16						16
36	Administrim-Biznes	42			13		10	12	22			99
37	Ekonomiks	9			9							18
38	Financë	42				22	16	12				105
39	Inic Ekonomike	6										6
40	Turizëm					17	9	12	17			55

KUOTAT DYTESORE TE PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

Tabela Nr. 3

Nr.	Marketing DEGA	UT	UPT	URT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AFFS	7
41	Marketing											
42	Mekanikë		12									12
43	Insh. Materiale		6									6
44	Tekstil		6									6
45	Elektrik		10									10
46	Elektronik		14									14
47	Ndërtim		23									23
48	Arkiteturë		11									11
49	Insh. Matematike		4									4
50	Insh. Fizike		4									4
51	Insh. Gjeodez		5									5
52	Insh. Ambienti		6									6
53	Insh. Ne shkencat e tokës		80									80
54	Gjeoinformatike		60									60
55	Insh. I Gjeoburimeve		10									10
56	Drejtim Femash dhe AGB			20			5					25
57	Ekonomi dhe P. Agrare			20								20
58	Insh. Agr. ne Hortikulture dhe MB			10								10
59	Insh. Agr. ne P. Bimor			10								10
60	Insh. Agr. ne Zootek. dhe B. Bilek			10								10
61	Akuakulture dhe M. Peshkimi			13								13
62	Insh. Agronjedi			15								15
63	Tek. Agroushqimore			10								10
64	Vrëshari dhe Enologji			6								6
65	Insh. Pyesh			10								10
66	Insh. P. Druri			7								7
67	Veterinari			13								13
	GJITHESHT	393	125	144	167	175	106	220	161	0	12	1503

VENDIM
Nr.597, datë 22.9.2005

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.547, DATË 3.8.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN E SHKOLLËS UNIVERSITARE PUBLIKE
“UNIVERSITETI I BERATIT””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 125 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Vendimi nr.547, datë 3.8.2005 i Këshillit të Ministrave “Për hapjen e shkollës universitare publike “Universiteti i Beratit””, shfuqizohet.
 2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.598, datë 22.9.2005

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.546, DATË 3.8.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN E SHKOLLËS UNIVERSITARE PUBLIKE
“UNIVERSITETI I FIERIT””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 125 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Vendimi nr.546, datë 3.8.2005 i Këshillit të Ministrave “Për hapjen e shkollës universitare publike “Universiteti i Fierit””, shfuqizohet.
 2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.599, datë 22.9.2005

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.548, DATË 3.8.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN E SHKOLLËS UNIVERSITARE PUBLIKE
“UNIVERSITETI I DURRËSIT””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 125 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendimi nr.548, datë 3.8.2005 i Këshillit të Ministrave “Për hapjen e shkollës universitare publike “Universiteti i Durrësit”, shfuqizohet.
 2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**V E N D I M
Nr.22, datë 26.9.2005**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 31.5.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.13 Akti që i përket:

KËRKUESI: OREST MALUSHI, përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi, me prokurë.
SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr.207, datë 27.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.18, datë 6.2.2002 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.366, datë 7.6.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.

Kërkuesi ka pretenduar përpara Gjykatës Kushtetuese se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime kryesore:

- Është hetuar e gjykuar në mungesë, pa dijeninë e tij dhe të familjarëve. Nga data e fillimit të procedimit penal deri në caktimin e mbrojtësit kryesisht, janë bërë disa veprime procedurale pa praninë e tij. Mbrojtësi kryesisht nuk ka mundur të kontaktojë asnjëherë me familjarët e të gjykuarit. Mosnjoftimi i tij dhe i familjarëve ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

- Mungesa e njoftimit për të pandehurin ose familjarët e tij për gjykimin në shkallë të parë, për ankimin e prokurorit, si dhe për gjykimin në gjykatën e apelit ka shkelur të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për t’u dëgjuar, në kuptim të neneve 31/b dhe 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe të nenit 6/3/b të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

- Shkeljet që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor, të ngritura në rekurs,

padrejtësisht, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka trajtuar në dhomën e këshillimit dhe nuk i ka dhënë zgjidhje në seancë gjyqësore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuarit, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuari është dënuar me 5 vjet burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.207, datë 27.11.2001, për veprën penale të vrasjes me dashje të mbetur në tentativë dhe armëmbajtje pa leje.

Mbi rekursin e prokurorit, Gjykata e Apelit Korçë ka ndryshuar vendimin përse i përket masës së dënimit në 10 vjet burgim.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.366, datë 7.6.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Kërkuari është gjykuar e dënuar në mungesë. Gjatë procesit gjyqësor atij i është caktuar mbrojtës kryesisht. Me shkresën e datës 13.5.2004 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë është njoftuar babai i kërkuarit për vendimin penal të Gjykatës së Lartë nr.366, datë 7.6.2002. Nisur nga fakti se familja e të dënuarit është vënë në dijeni për vendimin e fundit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me këtë shkresë, kërkuari, nëpërmjet avokatit të caktuar nga familjarët, ka bërë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me objekt shfuqizimin e vendimeve të sipërcituara.

Në kërkesën e paraqitur, mbrojtësi i caktuar nga familjarët i referohet nenit 30 pika 2 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin thuhet se “Kërkesa e individit ... paraqitet jo më vonë se 2 (dy) vjet nga konstatimi i shkeljes. Sipas tij, afati i paraqitjes së kërkesës është 2 (dy) vjet nga data e njoftimit të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Gjykata Kushtetuese çmon se paraprakisht duhet analizuar nëse pretendimi i kërkuarit për antikushtetutshmërinë e vendimeve të sipërcituara është paraqitur ose jo brenda afatit 2 (dy)-vjeçar të parashikuar nga ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.”.

Kërkesa për shfuqizimin si antikushtetuese të tre vendimeve gjyqësore është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 19.11.2004 nga mbrojtësi i caktuar me prokurë nga babai i të gjykuarit. Ai ka pretenduar mospasjen dijeni se ndaj djalit të tij ka filluar procedimi penal për akuzën e vrasjes dhe se janë marrë tre vendime gjyqësore nëpërmjet të cilave është dënuar me burgim. Mbi këtë bazë, ai e konsideron se marrja dijeni për ushtrimin e kërkesës kushtetuese ka filluar nga data 13.5.2004, datë në të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka lëshuar një shkresë nëpërmjet së cilës vë në dijeni familjarët e të gjykuarit për ekzistencën e vendimit penal të Gjykatës së Lartë nr.366, datë 7.6.2002.

Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është përpiluar nga mbrojtësi i caktuar nga familjarët. Në këto kushte Gjykata Kushtetuese çmon se dijenia për ekzistencën e një vendimi të formës së prerë dhe mbi këtë bazë e nisjes së afateve për ankimin kushtetues, është e lidhur me mundësitë që ka pasur i përfaqësuari, në rastin konkret babai i të gjykuarit, për të qenë i informuar për një fakt të tillë.

Përderisa, babai i të gjykuarit në bazë të ligjit ka pranuar të autorizojë me prokurë mbrojtësin për të ushtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, ai kishte detyrimin të provonte se objektivisht ka qenë në pamundësi për t’u vënë në dijeni për ngjarjen dhe se afati ligjor për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese ka kaluar për rrethana që nuk vareshin prej tij.

Nga shqyrtimi i të dhënave që ndodhen në dosjen gjyqësore rezulton se automjeti që ka përdorur i akuzuari për kryerjen e veprës penale ka qenë në përdorim të babait të tij. Mbi bazën e provave të administruara dhe që lidhen me sekuestrimin, lënien në ruajtje dhe kthimin e automjetit babait të të gjykuarit, me pyetjen e tij, si dhe me të dhëna të tjera të rëndësishme mbi ngjarjen e ndodhur, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi i tij mbi mospasjen dijeni për fillimin e procedimit penal dhe dënimin e të gjykuarit nuk është i bazuar. Nga të gjitha të dhënat konkludohet se babai i të gjykuarit ka pasur dijeni për zhvillimin e procesit gjyqësor.

Në këto kushte Gjykata Kushtetuese nuk e konsideron të paraqitur në afatin ligjor kërkesën e

mbrojtësit të caktuar nga familjarët. Përfundimisht, pa hyrë në analizën dhe vlerësimin e pretendimeve të tjera të parashtruara nga kërkuesi, të cilat lidhen me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese konkludon se përderisa kërkesa është paraqitur tej afatit 2 (dy)- vjeçar që parashikon ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ajo duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “f” dhe 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në nenet 30 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I :

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE
4.	KODI PENAL
5.	KODI I PUNËS
6.	KODI I FAMILJES
7.	KODI CIVIL
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9.	KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 27.9.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë